



Buletini

- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
- * Aktivitetet tjera

Shkurt 2019

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Përgjegjësia penale e personave juridik

Më 4 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së organizoi trajnimin për gjyqtarë dhe prokurorë nga të gjitha regjionet e Kosovës me temë: “Përgjegjësia penale e personave juridik”.

Qëllimi i këtij trajnimi zbatimi i drejtë i institutit të përgjegjësisë penale të personave juridik dhe shqiptimi i sanksioneve penale adekuate.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan çështjet si në vijim: baza dhe kufiri i përgjegjësisë penale të personave juridik, procedura ligjore për shqiptimin e sanksioneve penale kundër personave juridik si dhe llojet e sanksioneve që mund të shqiptohen ndaj personave juridik.

Gjithashtu gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve praktike të shkëmbejnë përvojat, opinionet dhe të përfshihen në debat konstruktiv dhe gjithëpërfshirës. Në vazhdim të trajnimit u konkludua se Ligji nr. 04/L-030 për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale duhet të plotësohet me disa nene sepse ka paqartësi në mënyrë që zbatimi i tij në praktikë të jetë më i lehtë dhe mos të ketë kundërthënie në interpretimin autentik të tij.

Përfitues të këtij trajnimi janë gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit themelor nga gjitha regjionet e Kosovës.



Ndjeshmëria gjinore në të drejtat pronësore

Më 05, 06 dhe 14 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së me mbështetjen e USAID-it - "Programi i të Drejtave Pronësore – Property Rights Programe" në Gjilan, Mitrovicë dhe Pejë organizoj trajnimin me temë: "E Drejta në Pronë: Jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" në kuadër të PTV-së.

Qëllimi i këtyre trajnimeve ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me çështjet e ndjeshme gjinore në të drejtat pronësore veçanërisht i faktorëve social, kulturorë dhe tradicional që pengojnë gratë në Kosovë për të ushtruar lirshëm dhe në mënyrë efektive të drejtat e tyre pronësore si dhe identifikimi efikas i këtyre faktorëve në praktikë dhe pengimi i padrejtësive eventuale në procedurë.

Në pjesën e parë u bë prezantimi i një pasqyre të situatës aktuale rreth çështjeve gjinore në të drejtat pronësore, procesi i socializmit, rolet dhe stereotipet gjinore. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan praktikrat dhe gjuha e ndjeshme gjinore. Gjatë trajnimit u vu në pah se burrat dhe gratë në Kosovë nuk janë të barabartë, në këtë kontekst informatat dhe të dhënat e mbledhura nga agjencionet e statistikave, institucionet dhe OJQ-të në Kosovë tregojnë që kjo pabarazi vazhdon të jetë e përhapur në çdo sektorë.

Një hulumtim i realizuar nga Programi i USAID-it për të drejtat Pronësore në vitin 2017 tregoi se afërsisht 20 % e grave në Kosovë kanë prona

në emrin e tyre, nga kjo vetëm 7.8 % është pronë e trashëguar nga familjet e tyre të lindjes. Në vazhdim u konkludua se një qasje e ndjeshme gjinore nga gjyqtarët është shumë me rëndësi. Përmes kësaj qasjeje merren në konsideratë nevojat specifike të grave dhe burrave. Për të përdorur qasje të ndjeshme gjinore duhet të kemi vëmendjen tek rolet dhe përgjegjësit e ndryshme që kanë gratë dhe burrat varësisht prej kontekstit në të cilin jetojmë.

Gjithashtu u konkludua se koncepti i senzibilitetit gjinor është zhvilluar në mënyrë që të zvogëlojë barrierat të krijuara nga pabarazia gjinore. Ky koncept u mundëson grave dhe burrave të zhvillohen në aspekt personal dhe profesional.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga ekspertët, përmes materialit të ofruar, analizës së rasteve hipotetike që ngërthenin për diskutim praktikrat kulturore e sjelljet shoqërore, si dhe ndërlidhjet e tyre të mundshme në vendosjen e rasteve të ushtrimit të së drejtës pronësore të grave dhe vajzave në Kosovë.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional të Gjykatës Themelore në Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjakovë.

Sigurimi i kërkesëpadisë

Më 7 shkurt 2018, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Sigurimi i kërkesëpadisë”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me kushtet për caktimin e masave të sigurimit, llojet e masave të sigurimit të kërkesëpadisë, masat e përkohshme, kompetenca për të vendosur për masat e sigurimit të kërkesëpadisë.

Gjatë trajnimit u shtjellua përmbajtja e aktvendimit mbi caktimin e masës së sigurimit,

masat e përkohshme, kompetenca për të vendosur për masat e sigurimit të kërkesëpadisë si dhe dallimi në mes të masës së përkohshme siguroese dhe masës siguroese, garancioni me rastin e caktimit të masës së sigurimit të kërkesëpadisë.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, gjithashtu janë trajtuar raste nga praktika, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjatë punës së tyre praktike. Përfitues të këtij trajnimi janë: Gjyqtarët e Gjykatave Themelore-Departamenti civil.



Trajnimi në vendin e punës për prokurorët, që shërbejnë si pikë fokale për BJN dhe për Koordinatorin për BJN në Kryeprokurorinë e Shtetit si autoritet i ndërmjetëm

Më 7 dhe 8 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me GIZ ka realizuar trajnimin me temë “Trajtimi në vendin e punës për prokurorët, që shërbejnë si pikë fokale për BJN dhe për Koordinatorin për BJN në Kryeprokurorinë e Shtetit si autoritet i ndërmjetëm”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e bashkëpunimit ndërkombëtarë dhe funksionalizimi i pikave fokale në hetimin, grumbullim e provave, ekstradim dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë

Ky trajnim trajtoj rolin dhe detyrat e prokurorit si pikë fokale për bashkëpunimin juridik ndërkombëtar. Po ashtu u prezantua roli dhe detyrat e prokurorit në autoritetin e ndërmjetëm

si koordinator për pikat fokale të bashkëpunimit juridik ndërkombëtar, bashkëpunimi në mes të pikave fokale për ndihmën e ndërsjellë juridike në prokuroritë themelore dhe koordinatorin për BJN në Kryeprokurorinë e Shtetit si autoritet i ndërmjetëm. Vëmendje iu kushtua shqyrtimit paraprak të kërkesave të brendshme nga pikat fokale, shqyrtimi formal nga koordinatori, fushëveprimi i shqyrtimit formal/vendimet dhe propozimet e arsyeshme për grupet e rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin zëvendës kryeprokurorja e shtetit, kryeprokuror, prokuror nga prokuroria speciale si dhe prokuror nga niveli themelor nga të gjitha regjionet e Kosovës.



Kontratat në ekonomi

Më 11 dhe 12 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së organizoj trajnimin me temë: “Kontratat në ekonomi”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me kontratat në ekonomi dhe zbatimin e drejtë të dispozitave ligjore të LMD-së si dhe Konventës për Shitjen Ndërkombëtare të mallrave.

Në ditën e parë u trajtuan kontrata e franshizës, kontrata e asignacionit dhe kontrata lizingut dhe karakteristikat e tyre. Ndërsa në pjesën e dytë u trajtuan kontrata për shitje ndërkombëtare të mallrave, kontrata mbi kredinë, kontrata për licencën dhe kontratat tjera publike, llojet e tyre dhe karakteristikat tjera.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua se në ekonominë e tregut bizneset e zhvilluara të cilat merren me veprimtari specifike, përdorin kontrata që janë specifike për afarizimin e tyre, e të cilat dallojnë si për nga struktura ashtu edhe nga të drejtat dhe detyrimet që krijojnë për palët. Kontratat specifike që përdoren në afarizëm, punët bankare dhe siguruese kanë gjetur përdorim shumë të madh në fushën e afarizmit duke pasur parasysh hapjen e tregut.

Më tej u potencua se shoqëritë tregtare gjatë zhvillimit të biznesit në sferën ndërkombëtare shpesh aplikojnë kontratat për të cilat zbatohet Konventa për shitje ndërkombëtare të mallrave. Lidhur me këtë në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga këto kontrata është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes dhe trajtimi i kësaj tematike është i një rëndësie të veçantë për avansimin e njohurive të gjyqtarëve në trajtimin e këtyre rasteve.

Në vazhdim u vequa se në sistemin juridik tregtar të vendit tonë raportet kontraktuese janë të rregulluara me LMD-në si ligj bazik. Dispozitat e LMD-së, që kanë të bëjnë me

kontratat, zbatohen si tek raportet juridike-kontraktuese në mes të personave fizik ashtu edhe tek raportet juridike kontraktuese në mes të shoqërive tregtare dhe personave të tjerë juridik. Meqenëse në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve shpesh njëra nga palët nuk është kompani vendore dhe transaksionet marrin karakter ndërkombëtar, sipas LMD-së, zbatohet Konventa për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave – CISG, e cila zbatohet drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës.

Vëmendje të veçantë gjatë zhvillimit të negociatave e veçanërisht gjatë ndërprerjes së tyre iu kushtua edhe parimeve të së drejtës së detyrimeve siç janë: parimi i ndershmërisë dhe ndërgjeshmërisë dhe parimi i ndalimit të shkaktimit të dëmit tjetrit, parime këto që përmbahen në LMD.

Më tej u konkludua se afarizmi bankar është veprimtari e veçantë ekonomike, objekt themelor i së cilit është qarkullimi i parasë, por ai përmban edhe disa transaksione dhe produkte tjera financiare. Në përgjithësi, bankat dhe institucionet financiare lehtësojnë veprimet afariste dhe shpeshherë ndodh që bankat specializohen në çështje specifike financiare që kërkohen nga tregu.

Gjatë këtij trajnimi pjesëmarrësit patën rastin që përmes rasteve nga praktika gjyqësore dhe analizës së tyre ti zbërthejnë dhe sqarojnë dispozitat e LMD-së dhe ligjeve tjera në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike, Departamenti për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit, si dhe gjyqtarët e gjykatave themelore të divizioneve civile nga departamentet e përgjithshme dhe bashkëpunëtorët profesional.

Hetimi i krimeve me armë

Më 11, 22 dhe 28 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP, në kuadër të trajnimeve në PTV, ka realizuar tri trajnime me temë “Hetimi i krimeve me armë”.

Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte avancimin i pjesëmarrësve lidhur me zbatimin e drejtë të Instrumentit Ndërkombëtar të Gjurmimit për të parandaluar qarkullimin e paligjshëm të armëve dhe për të rritur sigurinë publike si dhe për ngritjen e kapaciteteve të përfaqësuesve të nivelit qendror në hetimin e krimeve me armë.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan çështjet rreth hetimit të krimeve me armë, grumbullimin

e informacionit dhe inteligjencës si dhe përdorimin e masave të posaçme hetimore për rastet e krimit të organizuar.

Në veçanti u elaborua gjurmimi dhe përcaktimi e i rrugëve të trafikimit si pjesë përbërëse e këtyre hetimeve. Gjatë këtij pjesëmarrësit patën rastin të njihen me praktikat më të mira nga ekspertë vendor dhe ndërkombëtarë të kësaj fushe.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokuror dhe bashkëpunëtor profesional të nivelit themelor.



Krimi i organizuar

Më 13 shkurt 2019 Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Krimi i organizuar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve pjesëmarrës në implementimin e drejtë të dispozitave të Kodit Penal me të cilat janë sanksionuar veprat penale që ndërlidhen me krimin e organizuar si dhe problemet të cilat paraqiten në praktikë.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtua krimi i organizuar si formë e kriminalitetit që kryhet nga një grup personash të strukturuar dhe të organizuar me qëllim të përfitimit të drejtpërdrejt ose tërthorazi të dobisë financiare. Më tej u veqta konkludimi se krimi i organizuar kërcënon seriozisht zhvillimin e demokracisë

dhe shtetit të së drejtës duke cenuar të drejtat e njeriut, sigurinë dhe zhvillimin ekonomik të shtetit. Vëmendje parësore, iu kushtua parandalimit, hetimit dhe ndëshkimit të krimit të organizuar që në pjesën dërmuese të rasteve kjo veprë penale është e ndërlidhur edhe me vepra tjera penale si trafikimi me qenje njerëzore, veprat penale kundër ekonomisë, kontrabandimi me mallra, veprat penale të narkotikeve etj.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë me rastin e hetimit dhe gjykimin të këtyre veprave penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor.



Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti

Më 19 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së, ka realizuar trajnimin me temën “Barazia gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në familje në veçanti”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve për dhunën në familje dhe format e shfaqjes së saj më fokus gjinor dhe zbatimi i drejtë i legjislacionit në fuqi për barazinë gjinore.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtua legjislacioni ndërkombëtarë dhe vendorë për barazinë gjinore, dhuna në familje dhe format e shfaqjes së saj me fokus gjinor dhe urdhri për mbrojtje, kushtet për caktimin e urdhrit për mbrojtje si dhe masat për parandalimin e dhunës, procedura gjyqësore për vendosje sipas kërkesës për

urdhër mbrojtje, hartimi dhe arsyetimi i vendimit sipas specifikave të çështjes duke respektuar dispozitat ligjore si dhe ekzekutimi dhe pasojat e mos ekzekutimit të urdhrit për mbrojtje.

Vëmendje të veçantë i është kushtuar çështjeve për të cilat gjyqtarët kanë pengesa gjatë shqyrtimit të rasteve që kanë të bëjnë me procedurat standarde të veprimit për mbrojtje nga dhuna në familje për të zbatuar në mënyrë precize dispozitat ligjore lidhur me procedurën dhe afatet për vendosje sipas kërkesave për urdhër mbrojtje.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e gjykatave themelore, si dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave.



Krimi Kibernetik dhe Provat elektronike

Më 19-22 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë ne bashkëpunim me projektin iPROCEEDS (Këshillit të Evropës) , në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Krimi Kibernetik dhe Provat elektronike “.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe përfituesve tjerë për mënyrën dhe implikimet dëshmuese të çështjeve të krimit kibernetik dhe të kontrollit, sekuestrimit dhe konfiskimit të të ardhurave të krimit online, si dhe instrumentet e disponueshme ligjore dhe qasjet ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtua Konventa e Budapestit për Krimin Kibernetik dhe aktet tjera ndërkombëtare duke i përfshirë edhe dispozitat ligjore të brendshme që sanksionojnë krimin

kibernetikë. Vëmendje parësore iu kushtua provave elektronike dhe të ardhurat të krimit kibernetik të cilat janë komplekse. Në vazhdim u vu në pah rëndësia e bashkëpunimit të institucioneve relevante të brendshme dhe ndërkombëtare si dhe ekspertëve të fushave të përkatëse për t'i hetuar dhe ndëshkuar këto krime të cilat çdo ditë e më tepër janë në rritje. Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët, prokurorët si dhe bashkëpunëtorët profesional nga niveli themelor.



E drejta për jetën – Neni 2 KEDNJ

Më 20 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së, organizoj trajnimin me temë: “E drejta për jetën – neni 2 i KEDNJ”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i kriterëve që përmbahen në dispozitat e nenit 2 të KEDNJ dhe aspektet procedurale për të drejtën e jetës.

Në pjesën e parë u zbërthyen aspektet substantivë të së drejtës për jetën, detyrimet e shtetit për mbrojtjen e individëve të cilët mbahen nën mbikëqyrjen e shtetit konform Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) si dhe interpretimet e GJEDNJ lidhur me aspektet procedurale të së drejtës për jetën.

Në pjesën e dytë u trajtuan situatat kur jeta nuk konsiderohet e privuar në kundërshtim me këtë nen, në rastet kur ky privim vjen nga përdorimi i forcës, i bërë absolutisht i domosdoshëm dhe zbatimi i drejtë i kriterëve që përmbahen në dispozitat e nenit 2 të KEDNJ dhe aspektet procedurale të së drejtës për jetën.

Gjatë këtij trajnimi u vu në pah se e drejta në jetë, e mbrojtur me nenin 2 të KEDNJ, me Protokolin 6 mbi heqjen e dënimit me vdekje në kushte paqësore, me Protokolin nr.13 mbi heqjen e dënimit me vdekje në të gjitha rrethanat, është njëra ndër të drejtat themelore e garantuar me KEDNJ dhe se shkelja e saj konsiderohet si shkelje më e rëndë e Konventës. Në vazhdim u potencua se në Republikën e Kosovës mbrojtja e kësaj të drejte bie në organet e ndjekjes penale: policisë, prokurorisë

së shtetit, gjykatave të rregullta, si atyre që zhvillojnë procedurën penale në shkallë të parë, ashtu edhe atyre që vendosin për ankesat kundër aktgjykimeve të shkallës së parë ose mjeteve të jashtëzakonshme juridike të lejuara në kontekstin e çështjeve juridiko-penale.

Në vazhdim u konkludua se shteti ka si detyrim mbrojtjen e individëve të cilët mbahen nën mbikëqyrje apo nën kontroll dhe për këtë arsye këta persona janë në pozitë të ndjeshme në lidhje me shtetin. Në veçanti, kur një individë që gëzon shëndet të mirë mbahet nën kontroll nga policia dhe më pas vdes, atëherë shteti i duhet të jap një shpjegim të qartë lidhur me rastin.

Gjithashtu u konkludua se për GJEDNJ nuk ka rëndësi nëse shkelja e Konventës është bërë nga organe me karakter legjislativ, administrativ apo gjyqësor. Për të përgjegjësia për shkeljen e Konventës ka karakterin e një përgjegjësie ndërkombëtare të shtetit, përderisa ai si subjekt i së drejtës ndërkombëtare është Palë e Lartë Kontraktuese në KEDNJ dhe në bazë të Nenit 1 të Konventës ka marrë përsipër që të garantojë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Gjatë këtij trajnimi përmes rasteve praktike dhe analizës së tyre, u zbërthyen dhe u sqaruan dispozitat e nenit 2. të KEDNJ.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët dhe prokurorët e të gjitha niveleve në Republikën e Kosovës si dhe bashkëpunëtorët profesional.

“E Drejta e pronësisë, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe të drejtat tjera sendore sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës”

Më 21 dhe 27 shkurt 2019 Akademia e Drejtësisë me përkrahjen e USAID-it - “Programi i të Drejtave Pronësore – Property Rights Programe” organizoj dy trajnime, një për regjionin e Gjilanit dhe Ferizajit dhe tjetrën për regjionin e Mitrovicës me temë: “E Drejta e pronësisë, mënyrat e fitimit të pronësisë dhe të drejtat tjera sendore sipas legjislacionit të aplikueshëm në Republikën e Kosovës”.

Me rastin e këtyre trajnimeve u trajtua Ligji për marrëdhëniet themelore pronëso- juridike, fitimi dhe mënyrat e fitimit të pronësisë. Në vazhdim janë trajtuar edhe mbrojtja dhe pushimi i të drejtës së pronësisë, posedimi dhe llojet e tij, servitutet – fitimi, llojet, mbrojtja dhe pushimi i tyre.

Gjithashtu u ofruan njohuri themelore mbi praktikën gjyqësore të gjykatave kompetente lidhur me vendosjen e kontesteve pronëso juridike sipas LMTHPJ dhe LPDTS, duke u thelluar në konceptet kryesore të dala nga kjo praktikë.

Në vazhdim u potencua se LPDTS kujdes të veçant i kushton rregullimit të së drejtës dhe të mënyrave të fitimit të pronësisë duke potencuar dy lloje të fitimit të pronësisë: fitimin origjinal

dhe derivativ të pronësisë. Derisa fitimi origjinal paraqet fitimin të cilin fituesi këtë të drejtë nuk e nxjerrë nga e drejta e mëparshme, por e fiton në mënyrë burimore, në bazë të fakteve juridike (sipas vetë ligjit, dhe në bazë të vendimit të organit shtetëror), ndërkaq, mënyrën derivative e karakterizon fakti se fituesi të drejtën e vet e nxjerrë nga e drejta e paraardhësit të tij (në bazë të punës juridike dhe me trashëgim).

Gjatë këtyre trajnimeve u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore dhe duke u shoqëruar me diskutime interaktive të lehtësuara nga ekspertët, përmes materialit të ofruar, analizës dhe shtjellimeve të tematikës, me fokus në zbatimin e drejtë dispozitave ligjore në praktikë nga gjykatat kompetente si dhe përmes shpjegimeve të dispozitave ligjore mbi mënyrat e fitimit dhe mbrojtjes së pronësisë, të posedimit, mbajtjes, përkatësisht parashkrimit, të servitutit sipas LPDTS-së.

Përfitues të këtyre trajnimeve ishin gjyqtarët e gjykatave themelore të regjionit të Gjilanit, Ferizajit dhe të Mitrovicës.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre

Më 25-26 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së në bashkëpunim me UNICEF ka realizuar trajnim dy ditor me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në rastet e ndryshimit të statusit të tyre”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte thellimi i njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve lidhur me rëndësinë e zbatimit gjyqësor për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në procedurën e kundërshtimit dhe vërtetimit të atësisë apo amësisë, mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në rastet e dhunës në familje, parimi i interesit më të lartë të fëmijës, mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore.

Trajnimi u fokusua në trajtimin e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve sipas legjislacionit pozitiv në Kosovë, në mënyrë specifike sipas Ligjit për Familjen por edhe të akteve tjera normative të

rëndësishme. Po ashtu krahasimi me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve posaçërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve në drejtim të krijimit të praktikave efikase në bazë të cilave duhet të jepet vlerësimi dhe vendimi profesional i mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në kontestet martesore.

Më tej, u elaborua mbrojtja e të drejtave të fëmijëve gjatë procedurës së shkurorëzimit, kriteret që merr për bazë gjykata në rastet e besimit të fëmijës, ruajtjes dhe kujdesit ndaj fëmijëve si dhe roli i Organit të Kujdestarisë në procedurën e besimit të fëmijës. Po ashtu u shtjellua çështja e alimentacionit, vendosja e kontakteve të fëmijëve me prindërit dhe vendosja e gjykatës për këto raste në mënyrë ex officio.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë si dhe bashkëpunëtorët profesional.



Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale

Më 28 shkurt 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Bashkëpunimi në kryerjen e veprës penale”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte ngritja e kapaciteteve profesionale në zbatimin e drejtë të hetimeve dhe procedurave gjyqësore në rastet e bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale.

Gjatë këtij trajnimi u trajtuan bashkëkryerja,

shtytja dhe ndihma në kryerjen e veprës penale, bashkimi kriminal dhe marrëveshja për të kryer veprën penale si dhe kufijtë e përgjegjesisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim.

Vëmendje të veçantë gjatë këtij trajnimi kishin veprat penale të cilat përbëjnë rrezikshmëri të madhe për shoqërinë në tërësi të cilat u trajtuan përmes rasteve nga praktika gjyqësore veçanërisht duke elaboruar dispozitat ligjore dhe duke identifikuar format e bashkëpunimit dhe përgjegjesisë individuale të secilit kryes të veprës penale.

Përfitues të këtij trajnimi ishin, gjyqtarë, prokurorë dhe bashkëpunëtorët profesional të gjykatave.



Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar dhe krimi i organizuar

Më 28 shkurt dhe 1 mars 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së në bashkëpunim me GIZ-in, ka realizuar trajnimin me temë “Bashkëpunimi juridik ndërkombëtar dhe Krimi i Organizuar”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte funksionalizimi i pikave fokale me qëllim të ngritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më të suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë në rastet e krimit të organizuar.

Ky trajnim trajtoj masat hetuese moderne trans-kufitare, dëgjimi i dëshmitarëve duke përfshirë paraqitjen e kërkesave nga avokatët mbrojtës, dëgjimi me video konferencë, theksimi i rrezikimit të dëshmitarëve (dëshmitari anonim, të mbrojtur). Po ashtu u trajtuan çështjet praktike që kanë të bëjnë me shkëmbimin e

ekspertizës, hetimet e fshehta në shtetet tjera - të mësuarit nga një rast konkret (kontrabandimi dhe shpërndarja e kundërligjshme e barnave me recetë) duke përfshirë edhe krijimin e ekipeve të përbashkëta hetimore - baza ligjore si pengesë, përvojat, sfidat, dhe praktikrat më të mira, duke përfshir marrjen e dëshmive elektronike, dhe të dhënat e përmbajtjes. Vëmendje i'u kushtua shqyrtimit paraprak të kërkesave të brendshme nga pikat fokale, shqyrtimi formal nga koordinatori, fushëveprimi i shqyrtimit formal/ vendimet dhe propozimet e arsyeshme për grupet e rasteve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë, prokurorë nga prokuroria speciale, zyrtarë nga Ministria e Drejtësisë, policë hetues nga Policia e Kosovës dhe zyrtar ligjor nga të gjitha



Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar

Në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar gjenerata gjashtë, edhe gjatë muajit shkurt ka vazhduar realizimi i aktiviteteve të planifikuara sipas plan programit të përcaktuar.

Në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar gjithsejtë 16 sesione trajnuese nga modulet: Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Nga nën moduli “Veprat penale të korrupsionit dhe kundër detyrës zyrtare” është realizuar një (1) sesion trajnues, ku janë diskutuar çështjet e veprave penale të korrupsionit sipas Kodit Penal, keqpërdorimi i pozitës zyrtare, përvetësimi në detyrë, mashtrimi në detyrë, marrja e ryshfetit, dhënia e ryshfetit, falsifikimi i dokumentit zyrtar, nxjerrja e kundërligjshme e vendimeve gjyqësore dhe zbulimi i fshehtësisë zyrtare.

Gjithashtu nga nën moduli: I pandehuri në procedurën penale janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapo emëruar kanë pasur mundësi të zgjerojnë njohurit e tyre rreth: kufizimit të drejtave të pandehurit gjatë procedurës penale, marrjes në pyetje e të pandehurit gjatë procedurës penale, pozitës së të pandehurit pas ngritjes së aktakuzës, i pandehuri gjatë procedurës për vlerësimin e ligjshmërisë së aktakuzës, gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor, të drejtat e të pandehurit për ushtrimin e mjeteve juridike, i pandehuri gjatë procedurës për dhënien e urdhrin ndëshkimor, dhe i pandehuri gjatë procedurës për dhënien e ndihmës juridike ndërkombëtare.

Nga nën moduli: Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale janë realizuar pesë (5)

sesione trajnuese ku pjesëmarrësit patën rastin të diskutojnë dhe të fokusohen lidhur me marrjen dhe ruajtjen e të dhënave apo provave nga dëshmitarët, thirrjen dhe mosparaqitjen e dëshmitarëve, marrjes në pyetje, marrjes së deklaratës në procedurë paraprake dhe mundësia hetuese e veçantë, kushtet e përgjithshme për marrjen në pyetje në procedurë paraprake, si dhe marrjen e deklaratës në procedurë paraprake ose mundësinë hetuese të veçantë.

Po ashtu, gjatë këtyre sesioneve trajnuese janë trajtuar edhe procesverbali i veprimeve në procedurë penale, regjistrimi i seancave me incizim audio dhe me incizim audio dhe video, stenografimi me dorë apo me makinë dhe transkriptimi, ndalimi i parashtrimit të pyetjeve që mund të zbulojnë identitetin, dëshmitarët bashkëpunues, marrja e drejtpërdrejtë në pyetje, marrja e tërthortë në pyetje dhe rimarrja në pyetje e dëshmitarit, mosparaqitja e dëshmitarit apo ekspertit në shqyrtim gjyqësor, dhe masat për sigurimin e përkohshëm të kërkesës pasurore juridike të drejtuar kundër personave të tretë.

Gjithashtu nga nën moduli: Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë janë realizuar dy (2) sesione trajnuese dhe janë trajtuar këto çështje: Thirrja, urdhërarrestit, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktise vendqëndrimin, ndalimi i të pandehurit për t’iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, obligimi i të pandehurit për paraqitjen më të afërt në stacionin policor dhe dorëzania.



Nga nën moduli: Administrimi i procedurës penale janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku gjyqtarët e sapo emëruar kanë avancuar njohurit e tyre rreth identifikimit të llojeve të vendimeve dhe komunikimit të tyre, dallimin e dorëzimit të rregullt dhe jo të rregullt të parashtrësave, zbatimin e drejtë të afateve sipas KPPK-së, identifikimin e aktgjykimet-aktvendimet dhe urdhëresat e ekzekutueshme si dhe avancimin e njohurive lidhur me imunitetin sipas të drejtës ndërkombëtare.

Gjatë muajit shkurt 2019, nga nën moduli: Negocimi i marrëveshjes për pranimin e

fajësisë është realizuar një (1) sesion trajnues dhe janë trajtuar këto çështje: Përkufizimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë, subjektet e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, iniciimi i procedurës për negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë, si dhe roli i Prokurorit të Shtetit në negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 11 ditë trajnim praktik në gjykata konform orarit të përcaktuar. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur pesë (5) gjyqtarë të komunitetit serb.

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit Shkurt 2019, në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapoemëruar, janë zhvilluar aktivitete si në trajnimin teorik po ashtu edhe në trajnimin praktik.

Në këtë periudhë në trajnimin teorik janë realizuar gjithsejtë gjashtë (14) sesione trajnuese nga modulet: “Kodi i Procedurës Penale”.

Nga nën moduli “Vendi i ngjarjes dhe Forenzika” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku prokurorët kanë pasur mundësi të thellojnë njohurit e tyre rreth vendit të ngjarjes, llojet e gjurmëve, fazat e këqyrjes së vendit të ngjarjes, pyetjet e arta të kriminalistikës, indiciet, klasifikimi i tyre, prania në vendin e ngjarjes si indicie, vetitë fizike të personit si indicie, sigurimi i vendit të ngjarjes, përcaktimi i madhësisë hapësinore, fazat e komunikimit në vendin e ngjarjes, rikonstruktimi ideor, skicimi i vendit të ngjarjes, shënimet, si dhe fotografimi i vendit të ngjarjes.

Gjithashtu në kuadër të nën modulit “Kontrolli dhe Konfiskimi” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese, ku pjesëmarrësit kanë pasur mundësi të avancojnë njohuritë rreth sekuestrimit, ngrirjen sipas nenit 264 të KPP-së, urdhër ndalesa sipas nenit 265 të KPP-së, konfiskimi i përkohshëm sipas nenit 267 të KPP-së, përcaktimi i dobisë pasurore të fituar me vepër penale, marrja e sendit nga neni 69 i KPRK-së, interpretime të dispozitave të ligjit mbi kompetencat e zgjeruara të konfiskimit, raste studimore nga gjykatat vendore dhe ato evropiane, si dhe studimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut lidhur me konfiskimin dhe sekuestrimin.

Sipas programit trajnues, për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar katër (4) sesione trajnuese nga nën moduli “Masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë” dhe

kanë shtjelluar temat si: thirrja, urdhër arresti, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi i të pandehurit për t’iu afruar vendit të caktuar dhe personave të caktuar, obligimi i të pandehurit për tu paraqitur në stacionin më të afërt policor, arresti shtëpiak, paraburgimi, diversioni, dorëzania, dhe ushtrime me raste praktike nga vendimet e gjykatave vendore.

Nga nën moduli “Provat në procedurën penale” janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku prokurorët e sapo emëruar kanë pasur rastin të diskutojnë rreth marrjes së provave gjatë hetimeve deklarimi i të pandehurit dhe dëshmia e dëshmitarit, dëshmia e dëshmitarit si provë në fazën e hetimeve, deklarimi i të pandehurit, disa nga provat e papranueshme sipas KPPK-së, ekspertimi, kontrolli dhe sekuestrimi i përkohshëm.

Gjatë muajit Shkurt prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar dhe 1 vizitë në institucione jo gjyqësore: Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar kanë realizuar (11) ditë trajnimi praktikë në prokuroritë përkatëse ashtu siç është paraparë me programin trajnues. Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 21 prokuror të sapo emëruar, dy prej tyre janë të komunitetit serb.



Raporti i vizitës së prokurorëve të sapo emëruar (Gjenerata VII) në “Agjencinë Kosovare të Privatizimit”

Më 06 shkurt 2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të programit të trajnimeve Fillestare, organizoi për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII) vizitë në “Agjencinë Kosovare të Privatizimit”.

Qëllimi i kësaj vizite ishte që prokurorët e sapo emëruar të njoftohen me procedurat e privatizimit të subjekteve të AKP-së, rolin e Agjencisë në procesin e privatizimit, verifikimin dhe shpalljen e fituesit të përkohshëm, aprovimin dhe refuzimin e ofertës si dhe për procesin e privatizimit dhe likuidimit në Kosovë.

Në kuadër të kësaj vizite, prokurorët u njoftuan për së afërmi me, infrastrukturën ligjore, punën, veprimtarinë, problemet me të cilat ballafaqohet ky institucion. Gjithashtu u pasqyrua struktura organizative e AKP-së, përfshirë edhe zyrat regjionale, të cilat janë nën menaxhimin e saj, procesi i vendimmarrjes në AKP dhe mandati i Bordit të Drejtorëve, si instanca kryesore vendimmarrëse.

Në këtë drejtim, u trajtuan edhe komponenta e shitjes së aseteve, dhe likuidimit të ndërmarrjeve si procese operative në AKP. Prokurorët patën rastin të njoftohen më shumë edhe për komisionet e AKP-së të cilat kanë rolin kryesor në shitjen dhe likuidimin e aseteve.

Si çështje me fokus të veçantë ishte edhe procedura tenderuese, ku pjesëmarrësit u njoftuan për së afërmi me mënyrën se si del një ndërmarrje në tenderim, afatet kohore, si dhe përmbllja e shitjes.

U trajtua edhe dallimi mes likuidimit dhe falimentimit si dy tema me rëndësi në punën e prokurorëve.

Përfitues të trajnimit ishin Prokurorët e sapo emëruar (gjenerata VII) 2018-2019.



Aktivitetet tjera

Takim me përfaqësues të Këshillit të Evropës

Prishtinë, 6 shkurt 2019, z. Valon Kurtaj Drejtori Ekzekutiv dhe znj. Valmira Pefqeli U.D. Koordinatore e Programit në Akademinë e Drejtësisë kanë pritur në takim znj. Isabelle Servoz-Gallucci- Shefe e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë dhe znj. Larissa Kireeva - nga Divizioni për Barazi Gjinore në Këshillin e Evropës në Strasburg.

Tema kryesore e diskutimit në këtë takim ishte prezantimi i projektit të ri të Këshillit të Evropës

për Çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Gjatë takimit u prezantuan komponentë e këtij projekti të cilat fokusohen në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje si dhe mënyra dhe forma e bashkëpunimit. Bashkëbiseduesit u pajtuan që të bashkëpunojnë në realizimin e aktiviteteve në fushën e dhunës në familje.



Parimet bazë të trashëgimisë

Me 28.02.2019 Akademia e Drejtësisë në kuadër të trajnimeve për profesionet e lira, me kërkesën e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas në mbështetje të UNDP, ka realizuar trajnimin me temë: “Parimet bazë të trashëgimisë”

Qëllimi i këtij trajnimi ishte zbatimi i drejtë i dispozitave ligjore të Ligjit për trashëgiminë dhe krijimi i praktikave më të mira në ofrimin e ndihmës juridike në çështje trashëgimore nga ana e zyrtarëve të ndihmës juridike falas.

Gjatë këtij trajnimi janë trajtuar çështjet si në vijim: Trashëgimia me ligj, trashëgimia me testament, pjesa e domosdoshme, rrethi i trashëgimtarëve që kanë të bëjnë me pjesën e domosdoshme, llogaritjen e pjesës së domosdoshme të trashëgimisë dhe cenimi i

pjesës së domosdoshme.

Në këtë trajnim janë diskutuar raste nga praktika e zyrtarëve të ndihmës juridike falas me ç’rast janë adresuar çështjet problematike dhe më komplekse të kësaj natyre, veçanërisht trashëgimtarët që nuk përfshihen në masën trashëgimore. Lidhur me këtë është udhëzuar se si palët mund të realizojnë të drejtën e tyre përmes padisë.

Përfitues në këtë trajnim ishin 28 zyrtarët e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas nga gjitha regjionet. Pjesëmarrës në trajnim ishin edhe përfaqësues të OJQ-ve si CRPK, CLARD, NORMA si dhe Femrat Aktive të Gjakovës.



Programi i praktikës në Akademinë e Drejtësisë

Më 12 shkurt 2019, në Akademinë e Drejtësisë, tre studentë nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe një studente nga Fakulteti Juridik i Kolegjit “ILIRIA”, kanë përfunduar me sukses programin e praktikës, që realizohet në kuadër të bashkëpunimit mes Akademisë së Drejtësisë dhe institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë.

Gjatë periudhës tre mujore të praktikës, studentet patën mundësi të mësojnë për së afërmi aktivitetet e Akademisë, të njihen me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe

prokurorial me fokus në pjesën e arsimit ligjor, të përfitojnë nga pjesëmarrja në trajnimet e Akademisë, si dhe të ndihmojnë në përgatitjen e trajnimeve e aktiviteteve të ndryshme dhe hartimin e raporteve për aktivitetet e organizuara nga Akademia e Drejtësisë.

Pas përfundimit me sukses të praktikës, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë në një koktej rasti, u shpërndau certifikata studentëve të cilët e kanë përfunduar programin e praktikës.



Takim i Akademisë me Komisionin për Trajnime të KGJK-së dhe përfaqësues të JSSP

Prishtinë 21 shkurt 2019, Në Akademinë e Drejtësisë është zhvilluar takimi ndërmjet përfaqësuesve të Akademisë së Drejtësisë, Komisionit për Trajnime të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe përfaqësuesve të Ambasadës



Amerikane në Prishtinë (JSSP).

Qëllimi i këtij takimi ishte koordinimi për organizimin e trajnimeve të detyrueshme për gjyqtarë për vitin 2019, të cilat trajnime janë:

Shkrimi dhe Arsyetimi Ligjor; Ndryshimet Legjislative; Etika Profesionale dhe Politikat Ndëshkimore.

Gjatë këtij takimi u diskutua edhe për Trajnimet për Etikën Profesionale të cilat janë zhvilluar gjatë vitit 2018 në Akademinë e Drejtësisë. Në këtë takim pjesëmarrësit u pajtuan për organizimin e një trajnimi shtesë për gjyqtarët që nuk kanë pasur mundësi që t'i plotësojnë orët e kërkuara në etikën profesionale.

Në fund të takimit, bashkëbiseduesit diskutuan edhe për çështje tjera rreth shkëmbimit dhe mirëmbajtjes së të dhënave sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarëve në trajnime në Akademinë e Drejtësisë.



Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, më 22 shkurt 2019, në Akademinë e Drejtësisë është mbajtur takimi i pesëmbëdhjetë me radhë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë i udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit z. Aleksandër Lumezi, Kryeprokuror i Shtetit.

Në këtë takim z. Valon Kurtaj, Drejtori Ekzekutiv i Akademisë, prezantoi Raportin Vjetor të Punës dhe Raportin Financiar të Akademisë për vitin 2018. Z. Kurtaj theksoi se Raporti Vjetor është hartuar në bazë të standardeve të cilat janë të caktuara nga Kuvendi i Kosovës ku në pjesën hyrëse paraqet të dhëna për veprimtarinë, funksionet dhe programet të cilat i zhvillon Akademia.

Raporti përmban të gjitha aktivitetet që ka realizuar Akademia e Drejtësisë gjatë vitit 2018, ndërsa raporti financiar i Akademisë paraqet një pasqyrë të buxhetit dhe shpenzimeve të AD-së për vitin 2018. Anëtarët e Këshillit Drejtues,

vlerësuan punën e Akademisë gjatë vitit 2018, ndërsa raportin vjetor e miratuan njëzëri.

Këshilli Drejtues në këtë takim miratoi Programin e Trajnimit Fillestar për gjyqtarë dhe kërkesën e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për fillimin e Trajnimit Fillestar për 37 gjyqtarët e ri të cilët janë dekretuar dhe miratoi emërimin e mentorëve në trajnimin praktik për këta gjyqtarë.

Gjatë këtij takimi Këshilli Drejtues diskutoi edhe për organizimin e trajnimeve me mbështetjen e donatorëve.

Në këtë takim Këshilli Drejtues, sipas agjendës, diskutoi dhe mori edhe disa vendime tjera me rëndësi për punën e Akademisë së Drejtësisë.



<https://ad.rks-gov.net>

**Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660
Fax: + 381 38 512 095
E-mail: infoad@rks-gov.net**